

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 21.11.2020

Problemi 1

Rona shpk është kompani e cila prodhon produkte të plastikës. Pasqyrat e saj financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2020 janë si në vijim:

	2020	2019
	€' 000	€' 000
Pasuritë		
Pasuritë jo qarkulluese		
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet	2,560	1,970
Totali i pasurive jo qarkulluese	2,560	1,970
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	690	610
Llogaritë e arkëtueshme	390	340
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	25	56
Totali i pasurive qarkulluese	1,105	1,006
Totali i pasurive	3,665	2,976
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme (€ 2 secila)	150	135
Rezerva e rivlerësimit	60	40
Fitimet e mbajtura	1,899	1,201
Totali i ekuitetit	2,109	1,376
Detyrimet afatgjata		
Kredi bankare	750	800
Totali i detyrimeve afatgjata	750	800
Detyrimet afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme	736	750
Mbitërheqja bankare	20	20
Tatimi i pagueshëm	50	30
Totali i detyrimeve afatshkurta	806	800
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve	3,665	2,976

1. Fitimi para tatimit i Rona shpk është €738,000. Shpenzimet e tatimit për vitin 2020 janë € 40,000;
2. Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet e Rona shpk me kosto më 1 janar 2020 ishin € 2,430,000. Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2020 ishin € 218,000;
3. Rona kishte realizuar humbje në shitje të pasurisë jo-qarkulluese prej € 20,000 në vitin 2020. Vlera neto në libra e pasurisë në datën e shitjes ishte € 300,000;
4. Shpenzimet e interesit për Rona shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020 ishin €46,000.

Kërkohet

Duke përdorur metodën indirekte, përgatitni një Pasqyrë të Rrjedhave të Parave të Gatshme për RONTRA për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020 (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Rona shpk

Pasqyra e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

	€ '000	€ '000
Aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	738	
Korrigjimet për:		
Zhvlerësimin	218	
Humbja kapitale	20	
Shpenzimet e interesit	46	
	<u>1,022</u>	
Rritja në LL/ A	(50)	
Rritja në stoqet	(80)	
Zvogëlimi në LL/P	<u>(14)</u>	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	878	
Interesi i paguar	(46)	
Tatimi i paguar	<u>(20)</u>	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet operative		812
Aktivitetet investuese		
Hyrjet e parasë nga shitja e PIP	280	
Daljet e parasë për blerjen e PIP (Shënimi 2)	<u>(1,088)</u>	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese		(808)
Aktivitetet financuese		
Emetimi i aksioneve	15	
Pagesa e kredisë	<u>(50)</u>	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet financuese	<u>(35)</u>	
Rrjedha neto e parasë gjatë vitit		(31)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët saldo në fillim	Shënimi 1	<u>36</u>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët saldo në fund	Shënimi 1	5

Shënimi 1	2020	2019
	€'000	€'000
Paraja e gatshme	25	56
Mbitërheqja bankare (overdrafti)	<u>(20)</u>	<u>(20)</u>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	<u>5</u>	<u>36</u>

Shënimi 2

Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet-VNL(`000)			
S`		1,970	
Rezerva e rivl.		20	
Blerja (shifër balancuese)		1,088	
			Shitja 300
			Zhvlerësimi 218
S``		2,560	

Problemi 2

Linda shpk është kompani e cila organizon evente. Më 31 dhjetor 2019 saldo në librin e arkës ishte € 30,783, përderisa saldo sipas ekstraktit bankar ishte € 31,875. Ka zbuluar transaksionet si në vijim:

1. Gjatë rishikimit të ekstraktit bankar, janë vënë re transaksionet si në vijim:

Kreditim i llogarisë nga pagesa e klientit	€ 2,476
Debitim direkt për pagesën e telefonit	€641

2. Një çek Nr. 1245 i dërguar te furnitori ende nuk është paraqitur në bankë, në shumë prej € 1,594 ;
3. Depozitat e parasë nga shitjet prej € 1,458 të bëra më 31 dhjetor 2019 ende nuk janë paraqitur në ekstraktin bankar.
4. Banka ka bërë gabim duke zvogëluar konton e kompanisë në shumë prej €780;
5. Linda shpk ka lëshuar një çek për pagesë ndaj furnitorit, i cili ka qenë në shumë prej € 564, mirëpo në librin e arkës është regjistruar si €465.

Kërkohet:

Përgatitni korrigjimet në librin e arkës dhe ekstraktin bankar për muajin dhjetor 2019
(10 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

Libri i arkës i korrigjuar			
Dhjetor	€	Dhjetor	€
31 Saldo	30,783		
		Diferenca në çek-gabimi	
		31	99
		31 Telefoni-debitim direkt	641
31 Kreditimi	2,476		
		31 Saldo në fund	<u>32,519</u>
	33,259		<u>33,259</u>
Harmonizimi i ekstraktit bankar			
Saldo e pakorrigjuar - 31/12/2019			31,875
Minus:Çeçet e paparaqitura			
	Çeku Nr. 1245		(1,594)
Plus: Depozitat në tranzit			1,458
Gabimi i bankës			780
Saldo e korrigjuar			<u>32,519</u>
<u>32,519</u>			

Problemi 3

Saldot e bilancit vërtetues të Doni shpk, një kompani e përfshirë në prodhimin e materialeve të konsumit për industrinë e pijeve, janë nxjerrë më 31 Dhjetor 2016 nga të dhënat e Doni shpk:

	Debi €	Kredi €
Shpenzimet administrative	245,870	
Lejimet për borxhet e dyshimta		14,800
Kredi bankare – 6% (e ripagueshme në 2026)		600,000
Ndërtesat	2,458,030	
Zhvlerësimi i akumuluar-Ndërtesat – 31.12.15		1,587,630
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	35,680	
Qeraja e arkëtueshme	22,000	
Shpenzimet e shpërndarjes	845,600	
Shpenzimet e interesit	15,000	
Stoqet – 31.12.15	425,600	
Aksionet e zakonshme – 150,000 aksione € 1.50 secila		225,000
Impijantet e prodhimit dhe pajisjet	846,500	
Zhvlerësimi i akumuluar - Impijantet e prodhimit dhe pajisjet		578,500
Blerjet	2,111,720	
Fitimi i mbajtur – 31.12.15		611,370
Rezerva e rivlerësimit		65,000
Të hyrat nga shitja		3,458,700
Premia në aksione		55,000
Llogaritë e pagueshme		457,800
Llogaritë e arkëtueshme	647,800	
	7,653,800	7,653,800

Duhet të bëhen korrigjimet e mëposhtme, para se të përgatiten pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016:

1. Stoqet në fund më 31 dhjetor 2016 ishin € 476,200. Duhet të regjistrohen shitjet shtesë me kredi në shumë prej € 24,000. DONI realizon fitimin bruto si përqindje e shitjeve prej 40% të shitjeve.
2. Një klient ishte i pakënaqur me disa mallra dhe dëshiron t'i kthejë ato. Doni është dakorduar me klientin që do të realizojë kthimin pra do të lëshojë një notë kreditore për kthim të 20% të mallrave dhe pjesën tjetër të mbetur të faturës e ka arkëtuar nga klienti. Shuma origjinale e faturës ishte € 6,800.

Për më tepër Doni beson se përqindja e lejimit për borxhet e dyshimta duhet të bëhet si 5% e llogarive të arkëtueshme.

3. Doni ka deklaruar dhe ka paguar dividendën prej 10% të vlerës nominale të aksioneve të zakonshme në vitin 2016;

4. Më 31 dhjetor 2015 jeta e vlerësuar e ndërtesave ishte 40 vite. Më 1 janar 2016 Doni ka blerë një ndërtesë të re në shumë prej € 250,000. Ndërtesa kishte jetë të vlerësuar prej 40 viteve dhe për të është paguar me para të gatshme. Më 31 dhjetor 2016, ka rivlerësuar ndërtesat në € 1,100,000. Për blerjen e ndërtesës kompania ka regjistruar si në vijim:

Debi Llogaria e pagueshme € 250,000

Kredi Kredia bankare € 250,000

5. Doni duhet të regjistrojë interesin vjetor prej 6% të shumës së pagueshme të kredisë në fund të vitit.
6. Shpenzimet e tatimit për vitin 2016 janë € 44,487. Doni ka bërë pagesë prej € 30,000 për tatimet gjatë vitit 2016;
7. Zhvlerësimi ndahet si në vijim:

Ndërtesat- 2.5% me metodën e saldove zbritëse

Impijantet e prodhimit dhe pajisjet- 15% me metodën e saldove zbritëse

Zhvlerësimi i impijanteve të prodhimit dhe pajisjeve kalkulohet i plotë në vitin e blerjes dhe nuk kalkulohet fare zhvlerësim në vitin e shitjes.

Kërkohe:

- b) Përgatitni Pasqyrën e të Ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016 (15 pikë)
- c) Përgatitni Pasqyrën e Pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016 (15 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

a)

Doni shpk- Pasqyra e të Ardhurave gjithpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor
2016

	€	€	€	€
Të hyrat nga shitja	3,458,700	24,000	(1,360)	3,481,340
KMSH LL2				<u>2,075,520</u>
Fitimi bruto				1,405,820
Shpenzimet administrative				(245,870)
Shpenzimet e shpërndarjes				(845,600)
Shpenzimet e borxheve të dyshimta				(18,450)
Shpenzimet e zhvlerësimit (LI/)				(68,210)
Fitimi operativ				227,690
<u>Shpenzimet e interesit (LL/)</u>				<u>(21,000)</u>
Fitimi para tatimit				206,690
<u>Shpenzimet e tatimit</u>				<u>(44,487)</u>
<u>Fitimi neto</u>				<u>162,203</u>

b)Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2016

Pasuritë

Pasuritë jo-qarkulluese

Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet 1,327,800

Pasuritë qarkulluese

Stoqet (476,200-14,400) 461,800

LL/ A (647,800+24,000-1,360-5,440) 665,000

-Lejimet (33,250)

LL/ A neto 631,750

Qeraja e arkëtueshme 22,000

Paraja dhe ekuivalentët e parasë 0

Totali i pasurive qarkulluese 1,115,550

Totali i pasurive 2,443,350

Ekuiteti

Aksionet e zakonshme 225,000

Premia në aksione 55,000

Rezerva e rivlerësimit (65,000+7,610) 72,610

Fitimi i mbajtur (Shënimi) 751,073

Totali i ekuitetit 1,103,683

Detyrimet

Detyrimet afatgjata

Kredia bankare 350,000

Detyrimet afatshkurta

Llogaria e pagueshme (457,800+250,000) 707,800

Overdrafti 261,380

Interesi i pagueshëm 6,000

Tatimi i pagueshëm(44,487-30,000) 14,487

Totali i detyrimeve 1,339,667

Totali i ekuitetit dhe detyrimeve 2,443,350

Llogaritjet:

1) Kmsh: st fillim 425,600
+blerjet 2,111,720
-st fund 461,800 (476,200-14,100 shih më poshtë)

KMSH 2,075,520

Regjistrimi i shitjes

Shitja 24,000

KMSH 14,400

Fitimi bruto(40% *24,000) 9,600

D	LL/A	24,000	
K	Të hyrat nga shitja		24,000
D	KMSH	14,400	
K	Stoqet		14,400

			€	€
2)	D	Të hyrat nga shitja (Kthimet e shitjeve	(20%*6,800)	1,360
	K	LI/A		1,360
	D	Paraja	(6,800-1,360)	5,440
	K	LL/A		5,440
	D	Shpenzimet e borxheve të dyshimta		18,450
	K	Lejimet		18,450

Kalkulimi i lejimeve:

LL/ A sipas BV	647,800
	+24,000 shitjet me kredi
	-1,360 kthimet e shitjeve
	<u>-5,440 arkëtimi i parasë</u>
	665,000
Lejimet $5\% \times 665,000 =$	33,250
Lejimet saldo në fillim nga BV	14,800
Rritja në lejime	18,450-shpenzime

3) D Fitimi i mbajtur	22,500	
K Dividenta e pagueshme		22,500
D Dividenta e pagueshme	22,500	
K Paraja e gatshme		22,500

4) Regjistrimi gabim:

D LL/P	250,000	
K Kredia bankare		250,000

Regjistrimi i saktë

D Ndërtesa-Kosto	250,000	
------------------	---------	--

K Paraja	280,000	
----------	---------	--

Korrigjimi

D Kredia bankare	250,000	
------------------	---------	--

K Ll/P		250,000
--------	--	---------

D Ndërtesa -kosto	250,000	
-------------------	---------	--

K Paraja		250,000
----------	--	---------

Kalkulimet për rivlerësimin:

Vlera e tregut	1,100,000
VNL e ndërtesës më 31/12/2016=Kosto- zhvl i akumuluar = (2,458,030 sipas BV+250,000 blerja)-(1,587,630 sipas BV+28,010 shp e zhvlerësimit shih më poshtë)=2,708,030-1,615,640=	1,092,390
Rezerva e rivlerësimit	7,610

Kalkulimi i shpenzimeve të zhvlerësimit për ndërtesën:

2.5% me metodën e saldove zbritëse

Kosto: (2,458,030 sipas BV+250,000 blerja)	2,708,030
<u>-Zhvl. i akumuluar sipas BV</u>	<u>1,587,630</u>
VNL e ndërtesës	1,120,400

Shpenzimet e zhvlerësimit=2.5%*1,120,400=28,010

Regjistrimi i rivlerësimit

Ndërtesa-Kosto	
S`2,458,030 Blerja 250,000	
Saldo më 31 Dhjetor 2,708,030	1,608,030 rezerva e rivlerësimit
Saldo e rivlerësuar 1,100,000	

Zhvlerësimi i akumuluar-ndërtesat	
	S` 1,587,630 Shp. e zhvlerësimit 28,010
1,615,640 rez e rivlerësimit	S`` 1,615,640

Regjistrimi në kontabilitet i rivlerësimit:

D: Zhvlerësimi i akumuluar-ndërtesat	1,615,640
K Ndërtesat-Kosto	1,608,030
K Rezerva e rivlerësimit	7,610

		€
5)	Kredia bankare sipas BV	600,000
	Minus: Gabimi në regjistrim	<u>(250,000)</u>
	Shuma e saktë	350,000
		350,000
	Shpenzimet e interesit 6%	21,000
	Shpenzimet e interesit nga BV	<u>15,000</u>
	Shpenzimet shtesë të interesit	6,000

- 6) Debi Shpenzimet e interesit 6,000
Kredi Interesi i pagueshëm 6,000

D	Shpenzimet e tatimit	44,487	
K	Tatimi i pagueshëm		44,487
D	Tatimi i pagueshëm	30,000	
K	Paraja e gatshme		30,000

7) Shpenzimet e zhvlerësimit për ndërtesat janë llogaritur në pjesën 4).

Shpenzimet e zhvlerësimit (Impijantet e prodhimit dhe pajisjet)=15%*VNL=15%*(846,500-578,500)=15%*268,000=40,200

Llogaritjet -Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet

	Impijantet	
	<u>Ndërtesat</u>	<u>Totali</u>
Kosto	2,458,030	846,500
Zhvlerësimi i akumuluar saldo në fillim	(1,587,630)	(578,500)
VNL më 1 janar 2016	870,400	268,000
Blerjet	250,000	-
	1,120,400	268,000
Zhvlerësimi vjetor i ndërtesave	(28,010)	0
Zhvlerësimi vjetor i impijanteve të prodhimit dhe pajisjet	0	(40,200)
	1,092,390	227,800
Rezerva e rivlerësimit	7,610	7,610
Vlera neto në libra më 31 dhjetor 2016	1,100,000	1,327,800

Problemi 4

Viona shpk është kompani e cila prodhon hekur për industrinë e ndërtimit. Më 1 maj 2017, Viona ka blerë kompaninë Linda shpk. Pasqyrat individuale të pozicionit financiar të kompanive më 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	Viona 31 dhjetor 2018		Linda 31 dhjetor 2018	
	€' 000	€' 000	€' 000	€' 000
Pasuritë				
Pasuritë jo qarkulluese				
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet		10,200		2,200
Investimi në Linda		2,500		---
Totali i pasurive jo qarkulluese		12,700		2,200
Pasuritë qarkulluese				
Stoqet	900		500	
Llogaritë e arkëtueshme	200		400	
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	<u>640</u>		<u>300</u>	
Totali i pasurive qarkulluese		1,740		1,200
Totali i pasurive		14,440		3,400
Ekuiteti				
Aksionet e zakonshme(€ 1 secila)	2,400		600	
Fitimet e mbajtura	<u>10,640</u>		<u>2,000</u>	
Totali i ekuitetit		13,040		2,600
Detyrimet afatshkurta				
Llogaria e pagueshme	<u>1,400</u>		<u>800</u>	
Totali i detyrimeve afatshkurta		1,400		800
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve		14,440		3,400

Duhet të merren parasysh edhe shënimet në vijim:

- a) Më 1 maj 2017, Viona ka paguar € 2,500,000 në para për të blerë 70% të ekuitetit të Linda. Vlera e drejtë e interesit jo kontrollues në blerje ishte 660,000 €;
- b) Në datën e blerjes, pjesa e ekuitetit e Linda shpk në pasqyrat financiare ishte si në vijim:

	€
Aksionet e zakonshme	600,000
Fitimet e mbajtura	<u>1,000,000</u>
Totali	1,600,000

- c) Në datën e blerjes, vlera e tregut e pasurive të Linda shpk ishte e njëjtë me vlerën në pasqyra, përpos një fabrike. Fabrika kishte vlerën e tregut për € 600,000 më të lartë se sa ajo në libra. Vlera e drejtë e fabrikës nuk është reflektuar në pasqyrat financiare të Linda shpk.
- d) Gjatë vitit 2018, Viona i ka shitur mallra Linda shpk për € 420,000. Viola realizon shitje me përqindje shtim mbi kosto prej 40%. Më 31 dhjetor 2018, 25% e këtyre mallrave ishin të pashitura nga Linda shpk;
- e) Tregtia ndërgrupore te llogaritë e pagueshme dhe llogaritë e arkëtueshme të grupit ishte në shumë prej € 200,000;

KËRKOHET:

- a) Kalkuloni zërin e mirë në blerje më 1 maj 2017;

5 pikë

- b) Përgatitni pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar për grupin Viona shpk më 31 dhjetor 2018.

15 pikë

Total 20 pikë

IJK në datën e raportimit 960

Viona shpk Pasqyra e pozicionit financiar e konsoliduar

	€/£' 000	€/£' 000
Pasuritë jo qarkulluese		
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe paisjet (10,200 + 2,200 + 600)		13,000
Zëri i mirë		960
Totali i pasurive jo qarkulluese		13,960
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet (900 + 500 - 30)	1,370	
LL/ A (200 + 400 - 200)	400	
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët (640 + 300)	940	
Totali i pasurive qarkulluese		2,710
Totali i pasurive		16,670
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme	2,400	
Fitimet e mbajtura	11,310	
IJK		960
		14,670
Detyrimet		-
Detyrimet afatshkurta		
LL/P (1,400 + 800 - 200)	2,000	
Totali i detyrimeve afatshkurta		2,000
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve		16,670

Problemi 5

Kompania private (PC) është në vitin e saj të katërt të operacioneve. Pronari i kësaj kompanie sapo ju ka punësuar juve si kontabilist me orar të plotë dhe ju jeni duke përgatitur pasqyrat financiare të kompanisë të cilat përfundojnë më 31 Dhjetor 2008.

a) Analiza e llogarive të arkëtueshme zbuloi këto informata:

Llogaritë e arkëtueshme – 1 Janar 2008	€450,000
Lejimi për llogaritë e dyshimta – 1 Janar 2008	€20,000
Shitjet me kredi (me afat pagese) gjatë 2008	€1,100,000
Arkëtimet nga klientët gjatë vitit 2008	€1,050,000

Analiza e moshimit të llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2008 thekson:

1. Gjatë vitit 2008 falimentoi klienti kryesor (DBD) dhe nga ky klient nuk do të ketë më arkëtime të llogarisë së arkëtueshme prej €22,000.
2. Pas regjistrimit në kontabilitet të llogarisë së arkëtueshme nga DBD, moshimi i llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2008 theksoi se kërkohet një lejim për llogaritë e dyshimta si 5% e saldoshës së llogarive të arkëtueshme.

Kërkohet:

Përgatitni regjistrimet në ditar apo llogari për të shlyer llogarinë e arkëtueshme të DBD-së dhe për të regjistruar shpenzimet e borxheve të këqija më 2008 dhe poashtu regjistroni edhe rritjen/zvogëlimin në lejimet për borxhet e dyshimta (përfshini kalkulimet tuaja të shpenzimeve të borxhit të keq). (15 pikë)

b) Analizat e stokeve zbuluan se saldo përfundimtare e stokeve në fund të vitit 2007 ishte mbivlerësuar me €15,000 si rezultat i një gabimi në numërimin fizik të stokeve. Stoqet në fund të vitit 2008 janë kalkuluar saktësisht.

Kërkohet:

Tregoni efektet e gabimit (nëse ka) në secilën nga elementet në vijim. Gjithashtu theksoni nëse secila nga elementet në vijim do të mbivlerësohet, nënvlerësohet apo nuk do të jetë e ndikuar (si dhe shumat përkatëse). (5 pikë)

- i) fitimi neto i vitit 2007
- ii) kosto e mallrave të shitura për vitin 2008
- iii) Fitimi i mbajtur i datës 31 Dhjetor 2008

Totali (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

a)

- i) Shpenzimet e borxheve të këqija 22,000
Llogaritë e arkëtueshme 22,000

ii)

Llogaritë e arkëtueshme

Saldo fillestare	€450,000	Arkëtimet nga klientët	1,050,000
Shitjet me kredi	<u>€1,100,000</u>	Saldo balancuese (përfundimtare)	<u>€500,000</u>
Totali	<u>€1,550,000</u>	Totali	<u>€1,550,000</u>

Lejimet për borxhet e dyshimta në fund = $(500,000 - 22,000) \times 5\% = 23,900$

Lejimet për borxhet e dyshimta

Saldo balancuese(përfundimtare)	<u>€23,900</u>	Saldo fillestare	€20,000
Totali	<u>€</u>	Shpenzimet e borxheve të dyshimta(shifër ekuilibruese)	<u>€3,900</u>
		Totali	<u>€23,900</u>

Shpenzimet e borxhit të dyshimta..... 3,900
Lejimi për llogaritë e dyshimta..... 3,900

Shpenzimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta = $22,000 + 3,900 = 25,900$

b)

- i) fitimi neto i vitit 2007 do të mbivlerësohet për €15,000.
ii) kosto e mallrave të shitura do të mbivlerësohet për €15,000.
iii) Fitimi i mbajtur më 31 Dhjetor 2008 nuk do të ndikohet pasi që gabimi i vitit 2007 do të kthehet mbrapsht gjatë vitit 2008.